



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:078604
Datë: 27.03.2024
Numri i dokumentit: 05509820

Ac.nr.5764/20

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Halide Reka, kryetare e kolegjit, Nora Bllaca – Dula dhe Ylber Shurdhiqi, anëtar, në çështjen juridike kontestimore të paditësit F.B. nga Prishtina, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson E.B.S., avokate nga Prishtina, kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve “BKS”, me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Labinota Vllasaliu, juriste, për kompensimin e dëmit, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, e paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.3209/12 të datës 23.06.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 12.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET si e bazuar ankesa e të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve “BKS”, me seli në Prishtinë, PRISHET Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.3209/12 i datës 23.06.2020, dhe lënda i kthehet të njëjtës gjykatë në rishqyrtim dhe rivendosije.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.3209/12 të datës 23.06.2020 në pikën I (një) të dispozitivit e ka aprovuar pjesërisht të bazuar kërkesëpadinë e paditësit F.B. nga Prishtina dhe e ka detyruar të paditurën Byroja Kosovare e Sigurimeve me seli në Prishtinë, që paditësit në emër të zhdëmtimit nga autopërgjegjësia, për aksidentin e datës 24.07.2012, t’ia paguaj shumat si vijon:

Në emër të dëmit jomaterial:

- për dhimbje trupore – fizike shumën prej 1,200.00 euro
- për frikën e pësuar shumën prej 800.00 euro

Në emër të dëmit material:

- për përkujdesje dhe ndihmë të personit të tretë shumën prej 100.00 euro
- për ushqim të përforcuar shumën prej 70.00 euro

Në pikën II (dy) të dispozitivit e ka detyruar të paditurën Byroja Kosovare e Sigurimeve, me seli në Prishtinë, që paditësit si në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit, t'ia paguaj shumën me kamatë ligjore si në mjetet e deponuara në bankë mbi një vit pa destinim të caktuar, duke llogaritur nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi me datë 23.06.2020 e deri në pagesën definitive dhe shpenzimet e procedurës gjyqësore, në shumën prej 599.00 euro, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcenim të përmbarimit ligjor.

Në pikën IV (katër) e ka refuzuar si të pa bazuar pjesën e kërkesëpadisë së paditësit, në emër të dëmit material dhe jo material, mbi shumën e gjykuara dhe atë: për dhimbje trupore – fizike shumën prej 2,300.00 euro, për frikën e përjetuar shumën prej 2,200.00 euro, në emër të ndihmës së personit të tretë në shumën prej 150.00 euro, në emër të ushqimit të përforcuar, në shumën prej 230.00, ndërsa e ka refuzuar në tërësi kërkesën e paditësit në emër të terapisë fizikale në shumën prej 200.00 euro.

Kundër këtij aktgjykimi e paditura në afat ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar të njëjtin për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore dhe vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike, me propozim për Gjykatën e Apelit në Prishtinë që aktgjykimin e ankimuar ta prishë dhe lëndën ta kthejë në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë për vërtetimin e përgjegjësisë për aksidentin.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar dhe komplet shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të LPK-së, ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi F.B. nga Prishtina, nëpërmes përfaqësues së autorizuar në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve “BKS”, me seli në Prishtinë, për kompensimin e dëmit nga baza e auto përgjegjësisë, me arsyet sikurse në padi.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, në seancën e shqyrtimit kryesor ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.3209/12 të datës 23.06.2020, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar gjykata e shkallës së parë ka theksuar se nga provat e administruara ka gjetur se nuk është kontestues fakti se incidenti ka ndodhur me datë 24.07.2012 me fajin e të siguruarit të t' paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve dhe se paditësi nga ky incident ka pësuar lëndime trupore, mirëpo kontestuese ishte baza juridike e kërkesëpadisë si dhe lartësia e saj.

Përkitazi me bazën e kërkesëpadisë gjykata duke ju referuar dispozitës së nenit 154, 158 dhe 178 të ligjit Mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve ka arsyetuar se përgjegjësia e të paditurës për kompensimin e dëmit konsiston në atë se incidenti është shkaktuar me fajin ekskluziv të t' siguruarit të t' paditurës, ndërsa për vërtetimin e lartësisë së dëmit të shkaktuar sipas propozimit të palëve ka bërë nxjerrjen e e provës me ekspertizë nga ana e ekspertëve mjekësor Dr.V.B., - Ortoped dhe Dr. N.M. – Psikiatër, të cilët pas ekzaminimit të drejtpërdrejtë të paditësit kanë vlerësuar se paditësi në incidentin e komunikacionit të datës 24.07.2012 ka pësuar ndrydhje të regjionit të dy kërcinjve, lëndime të cilat klasifikohen si lëndime të lehta trupore, të manifestuara me dhembje fizike të intensitetit të rëndë për 24 orë, kohë pas kohe deri në marrjen e terapisë kundër dhimbjes, dhembje fizike të intensitetit të mesëm – 14 ditë, kohë e nevojshme deri në rënien e hematomës dhe edemës në regjionet e ndrydhura, dhembje fizike të intensitetit të ulët edhe për 15 ditë, e shprehur me simptoma të lartcekura – 24 orë, kohë pas kohe, deri në marrjen e terapisë kundër dhimbjes. Paditësi ka pasur nevojë për ndihmën e personit të tretë në kohëzgjatje prej 6 ditësh për shkak të vështirësive në ecje si pasojë e ndrydhjes së regjionit të dy kërcinjve dhe i është nevojitur ushqim i përforcuar në kohëzgjatje prej 15 ditësh dhe atë ushqim të pasur me proteina, minerale dhe vitamin; i është nevojitur terapia fizikale në kohëzgjatje prej 5 ditësh për përforcim të muskujve të regjionit të dy kërcinjve pas ndrydhjes. Dr. N.M. të frikës nga vdekja e cila ka zgjatur disa sekonda, gjendje e tronditjes psikike për shkak të kërcënimit të drejtpërdrejtë për integritet të tij fizik. Frikë sekondare të intensitetit të lartë e cila ka zgjatur për 2 ditë, e shoqëruar me gjendje të reagimit akut ndaj stresit, pagjumësisë, rikujtimeve të shpeshta të ngjarjes traumatike, vështirësi të adaptimit me kushtet e trajtimit mjekësor, nervozes me rënie të koncentrimin, e cila ka kaluar në frikë sekondare të intensitetit të ulët që ka zgjatur për 3 muaj, e manifestuar me ankthe, vështirësi gjatë gjumit, rënie të disponimit fizik dhe vullnetit, rënies së koncentrimin, nervozës si dhe pasiguri gjatë pjesëmarrjes në komunikacion. Gjykata e shkallës së parë ekspertizave mjekësore në tërësi ua fali besimin pasi të njëjtat janë punuar në mënyrë profesionale dhe janë mjaftueshëm të argumentuara.

Në fund ka shtuar se nga provat e administruara dhe nga gjendja e vërtetuar faktike është vërtetuar se e paditura mban përgjegjësi për dëmin e shkaktuar paditësit dhe se e njëjta është e obliguar që paditësit t'ia kompensoj dëmin, në kuptim të dispozitave të nenit 4.6 të Rregullit 3 për Ndryshimin e Rregullit për Sigurimin e Detyrueshëm të Autopërgjegjësisë (që ka hyrë në fuqi më 1 tetor 2008) dhe nenit 178 al.1 dhe 154 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Për pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë gjykata ka arsyetuar se për kompensimin e dëmit jomaterial përtej shumës së gjykuar nuk do të ishte në harmoni me të mirën e shkelur dhe me qëllimin që kompensimi të ishte i drejtë, ndërsa për përkitazi me pjesën e kërkesëpadisë për kompensimin e dëmit material në emër të terapisë fizikale gjykata ka arsyetuar se e ka refuzuar në mungesë të provave materiale.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar është përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), e lidhur me nenin 160.4 të të njëjtit ligj. Gjendja faktike po ashtu del të mos jetë në mënyrë të plotë, me çka për pasojë ka pasur edhe zbatimin e gabuar të së drejtës materiale.

Gjykata ankimore vlerëson se janë të qëndrueshme pretendimet ankimore të t 'paditurës për shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore për faktin se aktgjykimi i atakuar, ka të meta të atilla, për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet. I njëjti aktgjykim nuk përmban arsye për faktet vendimtare të cilat kanë pasur ndikim në mënyrën e vendosjes dhe ato pak arsye të cilat janë dhënë nga gjykata e shkallës së parë, janë të paqarta, kontradiktore dhe pa mbështetje në provat dhe procesverbalet nga shkresat e lëndës. Nga arsyetimi i aktgjykimit nuk mund të kuptohet se cilat kanë qenë faktet vendimtare dhe në çfarë mënyre janë vërtetuar faktet e tilla, për të arritur deri te përfundimi mbi themelësinë e kërkesëpadisë.

Shkeljet tjera konsistojnë edhe në atë se gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar në mënyrë të plotë faktike rreth konstatimit dhe të provuarit të fakteve lidhur me bazën juridike të kërkesëpadisë e rrjedhimisht edhe lartësinë e saj. Kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar se ku konsiston përgjegjësia e të paditurës në raport me paditësin, pra nuk është vërtetuar se si ka ardhur deri te aksidenti i komunikacionit, mënyra e shkaktimit të aksidentit, kush është shkaktari i aksidentit dhe kontributin eventual të pjesëmarrësve në aksident, fakte këto të domosdoshme që të vërtetohet përgjegjësia e të paditurës në raport me paditësin. Referuar shkresave të lëndës rezulton se në vendin e ngjarjes është përpiluar procesverbali – raporti i aksidentit në të cilin është konstatuar se deri te aksidenti ka ardhur për shkak të pakujdesisë së ngasësit të motoçikletës, mirëpo për vërtetimin e drejtë dhe të saktë të gjendjes faktike gjegjësisht mënyrës se si ka ardhur deri te aksidenti, shkaktarin e aksidentit apo kontributin eventual gjykata e shkallës së parë ka dështuar që të vërtetojë këto fakte, e të cilat kanë qenë esenciale në këtë çështje kontestimore, për vërtetimin e bazës së kërkesëpadisë e rrjedhimisht edhe përgjegjësinë e të paditurës në raport me paditësin.

Për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe konstatimit jo të plotë të gjendjes faktike, gjykata ankimore vlerëson se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë edhe në shkelje lidhur me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, nga shkaku se e drejta materiale mund të zbatohet drejtë vetëm në rastin kur procedura është zhvilluar në mënyrë të rregullt dhe gjendja faktike është konstatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë.

Të gjitha këto të gjetura dhe konstatime të bëra si më lart nga gjykata ankimore, aktgjykimin e ankimuar e bëjnë jo të drejtë dhe pa mbështetje në ligj, me çka në rrethanat e tilla aktgjykimi i ankimuar u dashtë që të priset dhe lënda t'i kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje gjykatës së shkallës së parë, pasi që nuk pati kushte që aktgjykimi i ankimuar eventualisht të mund të ndryshohej.

Gjykata e shkallës së parë, në riprocedurë, në kuptim të gjetjeve dhe lëshimeve të konstatuara nga gjykata ankimore, udhëzohet që të konvokoj seancën e shqyrtimit kryesor, për të cilën në mënyrë të rregullt të ftoj palët ndërgjyqëse, të administrojë prova në drejtim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike përkitazi me bazën juridike ashtu që të bëjë nxjerrjen e provës me ekspertizë të komunikacionit në mënyrë që të vërtetohen faktet e sipërcituara e pastaj varësisht nga të gjeturat, përkitazi me bazën juridike të kërkesëpadisë të vendos edhe për lartësinë e kërkesëpadisë në bazë të provave dhe ligjit, duke dhënë arsyetim të mjaftueshëm për të gjitha pretendimet e palëve ndërgjyqëse. Në fund udhëzohet gjykata e shkallës së parë që me rastin e përpilimit të aktgjykimit, t'i ketë parasysh kërkesat ligjore që rrjedhin nga dispozitat e nenit 160 të LPK-së. Në çdo rast veprimet dhe vendimet e gjykatës duhet të jenë në harmoni me dispozitat ligjore dhe standardet e gjykimit të drejtë.

Nga të cekurat më lart, e në mbështetje të dispozitave nga neni 194 dhe 195 paragrafi 1 pika (c) e LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.5764/2020, me datë 12.03.2024.

Kryetarja e kolegjit
Halide Reka d.v